

VENDIM
Nr. 173, datë 7.7.2022

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2022**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.7.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/7 prot., datë 5.7.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 4801 prot., datë 1.07.2022, protokolluar në ERE me nr. 886/2 prot., datë 4.7.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 31,84 lekë/kwh për muajin qershor 2022, në të cilin është përfshirë edhe kosto e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 4707 prot., datë 28.6.2022, protokolluar në ERE me nr. 1035 prot., datë 30.6.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekësh/kwh për muajin qershor 2022, në të cilin është përfshirë edhe kostoja e disbalancave, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, 10 kV, si dhe 6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Mbështetur në nenin 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të bOrdit të ERE-s, datë 4.12.2017, e ndryshuar: tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Kostot e disbalancave do të llogariten dhe faturohen nga shoqëria, në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut të Balancimit dhe akteve të tjera në fuqi.

- Në lidhje me komponentët e tjerë të përlllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF për muajin qershor 2022, evidentojmë, se në përputhje me nenin 9 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përlllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja për muajin qershor 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse, si vijon:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Qershor 2022				
QERSHOR 2022		Nivelet e tensionit		
		35 kV	20/10/6 kV	
	Njësia	Çmimi	Çmimi	
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	27.47	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.82	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh	31.75	18.26

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022 do të jetë:

- 31,75 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18,26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2022, prej:

- 31,75 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18,26 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendrike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti